Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN)

Nikola Parapunov p.n., F.Postar 55

1060-Shkup, Maqedoni

E-mail: mcms@mcms.org.mk

Internet faqja: <http://www.mcms.org.mk>

Të gjitha të drejtat janë të ruajtura. Riprodhimi i cilësdo pjesë të këtij publikimi nuk mund të bëhet pa leje paraprake të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.



PLANI STRATEGJIK PËR
ZHVILLIM LOKAL TË
KOMUNËS SË

GOSTIVARIT

mars, 2006





PËRMBAJTJA

1. HYRJE	51
2. PROFILI I KOMUNËS SË GOSTIVARIT	53
3. QASJA DHE PROCESI PËR PËRPUNIM TË PLANIT	57
4. VIZIONI DHE QËLLIMET PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM LOKAL TË KOMUNËS SË GOSTIVARIT	60
4.1 VIZIONI	61
4.2 QËLLIME KRYESORE TË PLANIT	61
4.2.1 QËLLIMI 1	62
4.2.2 ANALIZA SWOT	63
4.2.3 LOGJIKA E INTERVENIMIT	64
4.2.4 PLANI AKSIONAR	65
4.3.1 QËLLIMI 2	66
4.3.2 ANALIZA SWOT	67
4.3.3 LOGJIKA E INTERVENIMIT	68
4.3.4 PLANI AKSIONAR	69
4.4.1 QËLLIMI 3	72
4.4.2 ANALIZA SWOT	73
4.4.3 LOGJIKA E INTERVENIMIT	74
4.4.4 PLANI AKSIONAR	75
4.5.1 QËLLIMI 4	76
4.5.2 ANALIZA SWOT	78
4.5.3 LOGJIKA E INTERVENIMIT	79
4.5.4 PLANI AKSIONAR	80



Përgatitja e Planit për zhvillim lokal të Komunës së Gostivarit është e ndihmuar nga ana e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) përmes programit Bashkëpunim rajonal Ndërkufitar- BRN i financuar nga ICCO –Holandë.

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar midis qeverive lokale dhe organizatave qytetare.

Në realizimin e programit janë të kyçur tri rajone kufirittare nga trekëndëshi Maqedoni-Kosovë-Shqipëri, këto janë: Komuna e Gostivarit (Maqedoni), Komunat e Prizrenit dhe Dragashit (Kosovë) dhe Komuna e Kukësit (Shqipëri).



1. HYRJE

Që të mund të parashikohet e ardhmja dhe të bëhet më e sigurt, është e nevojshme të përpunohet plan, i cili nëse është afatgjatë dhe i gjithanshëm, atëherë ai pranon atributin e strategjisë. Plani na tregon ku gjendemi, ku duam apo ku duhet të arrijmë, në çfarë mënyrë ta kryejmë këtë, cilat resurse na nevojiten për zbatimin e tij, cilat aktivitete në çfarë periudhë realizohen etj.

Me një fjalë, strategjia është dokument i tërë dhe i ndërlikuar në të cilin theksohen drejtimet dhe prioritetet zhvillimore si edhe masat, resurset e nevojshme dhe dinamika të zbatimit e tyre.

Një nga prioritetet e komunave në Republikën e Maqedonisë është përgatitja e “strategjive komunale” të ndryshme për promovimin dhe përparimin e mirëqenies ekonomike, sociale dhe ekologjike të komuniteteve, me qëllim të kontribuojnë për zhvillim të pandërprerë.

Në fillim të vitit 2002 u miratna Ligji i ri për vetëqeverisje lokale, ku janë të definuara kompetencat e reja të komunave. Në këtë ligj është definuar përveç tjerash, komunat janë përgjegjëse edhe për: planifikimin urban (urban dhe rural); mbrojtjen se mjedisit dhe ambientit natyror; zhvillimi ekonomik lokal (planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal, përforsimi i prioritetëve zhvillimore dhe strukturore, udhëheqje e politikës lokale ekonomike, përkrahje e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të sipërmarrjes në nivel lokal; dhe punët komunale.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) në bashkëpunim me organizatat partnerë Instituti për Demokraci dhe Medijim (IDM) nga Shqipëria dhe Qendra Zhvillimore e Kosovës (QZHK), formuan program për Bashkëpunim rajonal ndërkufitar (BRN) në cilin janë përfshirë komunat e trekëndëshit

ndënkufitar mes Maqedonisë-Shqipërisë-Kosovës: Gostivar (Maqedoni), Prizren dhe Dragash (Kosovë) dhe Kukës (Shqipëri).

Në kudër të programit, përveç të tjerave, ishte paraparë të punohet plan strategjik për zhvillim lokal të komunës.

Kjo ishte mundësi për Komunën e Gostivarit që t'i intensifitojë aktivitetet e veta nga aspekti i përpunimit të një plani strategjik për zhvillim lokal.

Për këtë qëllim fillimisht janë kryer disa trajnime të skuadrit komunal: Udhëheqje e cikël projekti, Planifikim strategjik; Planifikim veprimor; që në fund të organizohej mbledhje pune me kohëzgjatje disa ditësh për definim të planit për zhvillim lokal të Komunës së Gostivarit.

Duke i vlerësuar nevojat për përpunim të një plani strategjik efikas për zhvillim, dhe duke i pasur parasysh të gjitha aktivitetet vijuese, formohet ekipi për përgatitje të planit për zhvillim lokal të Komunës së Gostivarit. Ky ekip, me përkrahjen e eksperteve nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim ndërkombëtar, ka pasur për detyrë punimin e planit për zhvillim lokal të komunës.



2. PROFILI I KOMUNËS SË GOSTIVARIT

Vendpozita gjeografike

Komuna e Gostivarit gjendet ne pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, në pjesën e sipërme të luginës së Pollogut, në anën e jugut të Fushës së Gostivarit. Ka sipërfaqe prej 518,79 km², afër 2,9 % prej sipërfaqes së pëngjithohme të republikës.

Fizionomia e relievit i determinon drejtimet rrugore - Lugina e Pollogut në veri dhe kthesën e Bukoviqit në jug.

Koridoret më të rëndësishme për trafik tranzit janë: Udhë magjistrale M-4 Shkup-Ohër; hekurudha Shkup-Kërçovë dhe udhë rajonale Gostivar-Dibër-Ohër

Pranë barrierave malore të dalluara kah perëndimi dhe lindja, pozita e tillë i siguroj komunës vendpozitë të mirë gjeografike dhe gjeografike.

Pozita e volitshme e Gostivarit në kuptim të trafikut del nga disponimi i tij në kalueshmërinë nga lugina në pjesën kodrinore, ndërsa pozita gjeografike për sa u përket lagjeve, mundësoi që qyteti me lehtësi t'i kryej funksionet e tij qendrore.

Vetë qyteti për shkak të vendpozitës në rrafshinën e fushës së Gostivarit, ka mjaft hapsirë për zgjerim teritorial për arsye se gjendet në rritje dinamike të pandërprerë në kuptim ekonomik dhe demografik; si qendër e vetme administrative, kulturore, udhëheqëse, politike, ekonomike dhe kulturore të Pollogut të Sipërm.

Popullata

Gjendja e përgjithshme e popullatës në komunën e Gostivarit, si edhe në krahasim me popullatën në Republikën e Maqedonisë sipas gjinisë dhe strukturës kombëtare është e dhënë në tabelën në vijim (sipas regjistrimit të popullatës në RM nga viti 2002).

Tabela 1: Numri i përgjithshemi të banorëve në komunën e Gostivarit

Komuna	Total	Maqed.	Shqiptarë	Turq	Romë	Vlehë	Serbë	Boshnj.	Tëjerë
Gostivar	81.042	15.877	54.038	7.991	2.237	15	160	39	685
(%)	100	19,59	66,68	9,86	2,76	0,02	0,20	0,05	0,85
RM (%)	4,01	1,22	10,61	10,25	4,15	0,15	0,45	0,23	3,26

Popullatë me profesion aktiv

Në tabelën e ardhshme është dhënë vështrim i popullatës në komunën e Gostivarit me moshë prej 15 vjet dhe më shumë sipas aktiviteteve të tyre.

Tabela 2: Vështrim i popullatës aktive dhe profesioni i tyre

Komuna	Total	Ekonomikisht aktiv			Ekonomikisht jo-aktiv
		Të gjithë personat	Persona që kryejnë profesion	Persona që nuk kryejnë profesion	
Gostivar	35.711	13.504	7.195	6.309	22.207
(%)	100	37,81	53,28	46,72	62,16%

Karakteristikat gjeologjike

Terenet e komunës janë të përbëra nga shkëmbinijë nga paleoliti i lashtë (filitoide, metadi jabaze, rrasë të gjelbëra, rrasë kuarci dhe kuarcitë)

Sedimentet triasike janë me faci argjile, gur qëlqeror dhe rërë, ndërsa nga shkumësi janë të përfshira sedimente sipërschkumësi.

Sedimentet më të reja kvartere përbëhen nga sedimenti aluvial-proluvial dhe material moren në pjesët e larta malsore.



Karakteristika gjeotektonike

Në pamje gjeotektonike, komuna ka tektonikë mjaftë të ndërlikuar dhe me pjesën më të madhe bie në zonën e Sharrit –Pelisterit.

Relievi

Komuna e Gostivarit karakterizohet me reliev të llojllojshëm, cili është i pasur me forma karakteristike, me pozicionim të dalluar vertikal.

Lugina e Pollogut është krijuar si pasojë e trazirave të mëdhaja tektonike, gjatë rrjedhjes së liqenit që ka ekzistuar këtu, në periudhën e terciarit dhe kuareit, nëpër kanjonit të Dervenit pastaj në Vardar e deri në detin Egje.

Në këtë fazë gjeologjike është formuar relievi themelor i kësaj pjese të Ballkanit, me këtë edhe relievi themelor i luginës së Gostivarit.

Relievi malor ka karakter kodrinor-malor i cili është i përbërë nga malet: Mali i Thatë (1,853m l.n.d.) dhe Mali Sharr (2,748m l.n.d.).


Pjesët malore perëndimore janë të mbuluara me florë të begatshme që i jep karakter të dalluar pyllor; ndërsa pjesët lindore janë të pambuluara dhe të shkreta (Mali i Thatë dhe Zheden) për shkak të përbërjes me gur gëlqeror.

Relievi luginor e përbën lugina e Pollogut (300-600m l.n.d.).

Në thelbin e luginës është e vendosur fusha e pasur e Pollogut me lartësi mbi nivelin e detit prej 400 – 461m. Fusha e sipërme e Pollogut ka lartësi më të madhe mbi nivelin e detit prej fushës së poshtme (fusha e Tetovës) 461m. Lartësitë në vende të veçanta në fushës ndryshojnë për shkak të valëvitjes së terrenit..

Lidhjet e komunikimit

Që të arrihet në Gostivar nga Tirana, apo nga Ohri, Prishtina, Shkupi ose Tetova, shfrytëzohet udha moderne cila kalon nëpër Fushën e Pollogut. Gostivari është i vendosur skaj koridorit 8 që mundëson komunikim të shpejtë në të gjitha drejtimet. Të gjithë komunikimet, rrugore ose hekurudhore, mundësojnë qarkullim të shpejtë. 100km. Në jug gjendet aeroporti i Ohrit dhe afër 90km (në veri-lindje) është aeroporti i Shkupit.



3. QASJA DHE PROCESI PËR PËRPUNIM TË PLANIT

Qasja drejt definimit të vizionit dhe përcaktimit të strategjive për zhvillim të komunës së Gostivarit janë të përcaktuara në bazë të disa determinanta ve të rëndësishme:

- Analiza strategjike e situatës ekzistuese- analiza SWOT;
- Procesi rrjedhor i decentralizimit dhe kompetencat e reja të komunave;
- Definimi i drejtimeve strategjike në bazë të sektorëve ekonomik bartës dhe resursët ekzistues natyrorë.

Planifikimi

Zhvillimi i strategjisë dhe planifikimi janë ngushtë të lidhura mes veti dhe janë në lidhje me aktivitetet (veprimet) e ardhshme të komunës. Planifikimi bëhet me qëllim të përcaktohet zhvillimi i strategjisë dhe është më tepër i lidhur me orientimet (drejtimet) e ardhshme, sesa me qëllimet konkrete dhe aktivitetet.

Zhvillimi lokal është proces me të cilin komuna, në partneritet me sektorin publik, privat dhe civil, e përmirëson cilësinë e jetës së banorëve të vet përmes krijimit të mirëqenies të re ekonomike dhe shoqërore.

Në pjesën vijuese në mënyrë përshtuese është dhënë dënia dhe dobishmëria e analizës SWOT.

Analiza SWOT

Matrica-forma SWOT është zhvilluar si vegël e qartë për analizim të procesit të planifikimit të strategjisë. Kjo analizë është kombinim i analizave të branshme

(anët e forta dhe të dobëta) me analizat e jashtme (mundësitë dhe rreziqet). Prandaj analiza SWOT duhet të bazohet në njohuri solide të faktorëve dhe aktorëve ekzistues në mjedisin e punës si edhe analizë e resurseve të brendshëm dhe funksionimit të komunës.

Analiza SWOT është metodë e dobishme për analizë, e cila e ndihmon përcaktimin e prioritetëve, krijimin e vizioneve të përbashkëta dhe zhvillimin e strategjive të cilat do t'i përforcojë.

Domethënia e fjalës SWOT është: **Strengths** (Përparsitë), **Weaknesses** (Dobësitë), **Opportunities** (Mundësitë) dhe **Threats** (Kërcënime apo rreziqe).

Ky lloj analize ndihmon në përcaktimin dhe vlerësimin e përparsive konkurente. Çdo herë kur një ndërmarrje vendos të lokalizohet, merren parasysh përparsitë e rajonit.

Përparsitë e rajonit janë ato vlera apo faktorë që japin përparsi konkrete dhe e bëjnë vendin atraktiv, që do të thotë se janë karakteristika të qarta lokale të rajonit.

Dobësitë janë ato faktorë që paraqesin pengesë për zhvillimin ekonomik dhe mund të janë në formë sociale, fizike, udhëheqëse, operative etj.

Përparsitë dhe dobësitë janë faktorë të brendshëm të rajonit (Komunës), ndërsa mundësitë dhe rreziqet janë faktorë të jashtëm.

Mundësitë janë ata faktorë të jashtëm të cilët e lehtësojnë zhvillimin e përparsive konkurente.

Rreziqet janë trendet apo zhvillimet e papërshtatshme të jashtëm të cilët për ekonominë në komunat sjellin rënie të përparsive konkurente.

Në rastin tonë, analiza SWOT përdoret si bazë për përpunimin e planit strategjik duke i përfshirë detyrat, veprat dhe mjetet e duhura për zbatimin e tij, njëkohësisht duke mundësuar të përcaktohet drejtimi për analiza dhe hulumtime vijuese të anëve më të rëndësishme të forta dhe të dobëta të komunës, të duhura për shfrytëzimin e drejtë të mundësive apo për të zvogëluar rrezikun.

Krijimi i kushteve për rritje pozitive ekonomike të komunës në 3-5 vitet e ardhshme do të realizohet me themelimin të një sistemi të qëndrueshëm për shfrytëzim dhe udhëheqjen e resurseve lokale (ekonomi). Kjo do të mundësojë mbajtjen e vendeve pune të tanishme, dhe njëkohësisht do të krijoj kushte për hapjen e vendeve të reja pune, cili është kushti themelor për përmirësimin e standardit, me këtë edhe kualitetin e jetës në komunë.

Që ky plan të jetë real për t'u zbatuar, komuna njëherë duhet ta zbatojë procesin sistematik të planifikimit strategjik duke marrë hapa të përshtatshme për zhvillimin e vetë lokal. Që të themelohet në baza të shëndosha, ky proces duhet të realizohet sipas planit vijues:



1. Përpunimi i Profilit të Komunës së Gostivarit, me të dhëna për resurset që i ka në disponim;
2. Definimi i drejtimeve për zhvillim të komunës;
3. Formulimi i qëllimeve reale, detyrat dhe strategjitë;
4. Identifikimi dhe vlerësimi prioriteteve;
5. Zhvillimi dhe realizimi i planeve veprimore.

Strategjia për zhvillim lokal për periudhën 2006–2008, është e menduar në mënyrë që të kontribuojë për ndryshime të suksesshme strategjike në komunë. Plani është i motivuar nga vizioni për zhvillimin e komunës së Gostivarit dhe fokusohet në qëllime me numër të kufizuar të cilët do të veprojnë si trajni «polugi za promena». Këto qëllime do të arrihen nëpërmjet një serie të prioriteteve dhe masave. Ekipikomunal, me ndihmën e QMBN-së, bashkë i menduan të gjitha komponentat e planit strategjik, duke i përfshirë të gjitha konsultimet paraprake. Parimet e UE-së rreth qasjes së partneritetit planifikim të zhvillimit lokal është karakteristika kryesore e kësaj strategjie. Megjithëse plani është me afat të mesëm (3 vite), i njëjti është bazë e mirë për planifikim të mëtejshëm dhe krijim të kushteve reale për zhvillim të komunës.




4. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM TË KOMUNËS SE GOSTIVARIT

4.1. Vizioni

Vizioni paraqet përshkrim i gjendjes së ardhshme të dëshiruar ekonomike apo gjendjen zhvillimore të komunës (bashkisë). Vizioni duhet të jetë i formuar dhe i pranuar nga të gjitha palët e kyçra në proces. Edhe pse vizioni nuk është gjithnjë tërësisht i zbatueshëm, ai i jep komunës imazh të qartë për drejtimet.

Metodologjia e procesit të planifikimit strategjik në bazë të cilës është përpunuar ky plan, është e shfaqur në dijagramin vijues:





VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM TË KOMUNËS SË GOSTIVARIT

KOMUNËN E GOSTIVARIT E SHOHIM SI NJË MJEDIS MJAFT TË ZHVILLUAR, ME INFRASTRUKTURË MODERNE FUNKSIONALE E CILA MUNDËSON ZHVILLIMIN EKONOMIK ME NUMËR TË VOGËL TË PAPUNËSUARVE. ËSHTË VEND ATRAKTIV PËR INVESTUESIT KU JETOJNË GJENERATA TË EDUKUARA DHE TË MOTIVUARA, MJEDIS MULTITETNIK ME BASHKËJETESË TË SHËDOSHË MULTITETNIKE.

ME NJË FJALË, GOSTIVARI PARAQET KOMUNË EVROPIANE, E CILA I PËRMBUSH TË GJITHA KUSHTET PËR JETË DHE KU ÇDO NJERI DO TË DËSHIRONTE TË JETONTE.

Pas kryerjes së analizës strategjike të gjendjes ekzistuese -analiza SWOT, u përcaktuan qëllimet kryesorë të vizionit, të cilat përfshijnë pesë segmente mbartëse, mbi të cilat themelohet zhvillimi i mëtejshëm lokal i komunës së Gostivarit, ndërsa me analizën krahasuese u përcaktuan të njëjtat sipas prioritetit.

4.2. Qëllimet kryesore strategjike

1. Promovimi dhe tërheqja e investimeve lokale dhe të huaja, fonde të shtetit dhe agjenci të tjera.
2. Përmirësimi i gjithë infrastrukturës në funksion të kualitetit të jetës dhe zhvillimit lokal ekonomik të komunës.
3. Përkrahja e kapaciteteve ekzistuese industriale, si edhe bizneset ekzistues e private përmes adaptimit, themelimit, rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
4. Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe xehtarisë.

4.2.1. QËLLIMI 1

PROMOVIMI DHE TËRHEQJA E INVESTIMEVE LOKALE DHE TË HUAJA, FONDE SHTETËRORË DHE AGJENCI TË TJERA

Krijimi i kushteve për tërheqje të investimeve të cilat mund të vijnë nga burime të ndryshme është themelore për një bashkësi.

Në të kaluarën komuna e Gostivarit ka patur sukses në këtë fushë, mirëpo nuk ka qenë në sasi dhe lloj të nevojshëm.

Investimet e siguruara nga agjencite ndërkombëtar dhe institucionet shtetërore në formë të granteve, në mënyrë të dukshme e ndihmojnë zhvillimin lokal. Përveç kësaj tërheqja e kapitalit privat edhe më shumë e shpejton dhe lëviz zhvillimin ekonomik, që nga ana tjetër do të mundësoj ulje të papunsisë dhe krijimin e standardit më të mirë për jetë.

Numri i madh i të papunësuarve jashtë vendit, në mënyrë të përkohshme , posaçërisht në shtetet perëndimore të Evropës, përbëjnë investitorë “të mëdhej” potencial. Kapitali i freskët i cili mund të investohet në komunë duhet të jetë atraktiv dhe i sigurt që të sigurohen investime të reja.

Në të ardhmein, investimet private do të jenë forca lëvizëse e zhvillimit lokal ekonomik.

Komuna e Gostivarit, me vendpozitën e vetë, lidhjeve të mira rrugore, si edhe resurset ekzistuese natyrore, është vend tërheqës për investitorët e ardhshëm. Që të arrihet në Gostivar nga Shkupi, Prishtina apo Ohri, shfrytëzohet autostrada moderne e cila kalon nëpër fushën pjellore të Pollogut. Në të vërtetë, të gjitha komunikimet, udhore apo hekurudhore mundësojnë qarkullim të shpejtë. 100 km në jug gjendet aeroporti i Ohrit dhe përafërsisht 90 km në veri-lindje gjendet aeroporti i Shkupit.



4.2.2. ANALIZA SWOT

Qëllim	Promovimi dhe tërheqja e investimeve lokale dhe të huaja, fondet shtetërorë dhe agjencitë e të tjera
Përparësi	<ol style="list-style-type: none">1. Kapacitete ekzistuese njerëzore2. Komunë me ingjerenca të zqjeruara (komunë e decentralizuar)3. Administratë publike profesionale4. Komunikim cilësor elektronik5. Lokacion i volitshëm i komunës (koridori E-8, afërsia e aeroporteve në Shkup dhe Ohër)6. Ambient i volitshëm për biznes
Dobësi	<ol style="list-style-type: none">1. Organizim i pamjaftueshëm për tërheqje të fondeve2. Partneritet privat-publik i pandërtuar në nivel lokal3. Veprime të ngadalshme dhe të vrazhda administrative4. Mospregaditje e materialeve promovuese
Kërcënime	<ol style="list-style-type: none">1. Konkurrence jolojale në tregti (ekonomi e zezë)2. Hyrje e vështirë në kapital (shkallë e lartë të kamatave)3. Politizimi në hyrje në fondet shtetërorë4. Standardi i ulët i popullatës5. Korrupcioni6. Qeveria joefikase e gjykatës
Mundësi	<ol style="list-style-type: none">1. Resurset dhe potencialet ekzistuese natyrore2. Klima e krijuar për zhvillim të zejeve tradicionale3. Kushte të mira për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)4. Rajon i pastër ekologjik5. Rritja e biznesit privat6. Hyrje e mundësuar në fonde rajonale të UEsë7. Ekzistimi i programeve zhvillimore donatore në Maqedoni

4.2.3. LOGJIKA E INTERVENIMIT

PROBLEM	MASA	AKTIVITETE
Fonde dhe investime të pamjaftueshme për zhvillim të komunës	1. Krijim i kushteve për tërheqje të fondeve në komunën e Gostivarit	1.1 Formim i ekipit nga Njësi të vetëqeverisjes lokale (NJVL), sektorit privat dhe publik (partneritet) 1.2 Trajnim i ekipit për qasje në fonde, planifikim projektor dhe aftësi komunikimi 1.3 Përgatitje të një udhëzuesi për investuesit 1.4 Shqyrtim për nevojë për kuadër 1.5 Krijim dhe azhurim i WEB faqes me projekte aktuale dhe të ardhshme 1.6 Themelimi i kontakteve me investues lokal dhe të huaj 1.7 Bashkëpunimi i rregullt me të gjitha institucionet shtetërore
	2. Promovimi dhe tërheqja e fondeve nga burime të ndryshme	2.1 Promovimi i partneritetit 2.2 Lobim rrjedhor deri te të gjithë aktorët relevant (donatorë ndërkombëtarë dhe të vendit, institucione shtetërore) 2.3 Takime të hapura tremujare me sektorin privat 2.4 Prezantim në mediat 2.5 Mundësim të kushteve lehtësuese për investuesit e ardhshëm (taksa komunale dhe administrative) 2.6 Botimi i broshurave për biznese aktive dhe të mundshëm në Gostivar 2.7 Praktikimi i sistemit një sportel





4.2.4. PLANI AKSIONAR

Krijimi i kushteve për tërheqje të fondeve në komunën e Gostivarit

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRÇJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Formim i ekipit nga NJVL, sektorit privat dhe publik (partneritet)	X						NJVL në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat	5.000 €
2	Trajnimi i ekipit për qasje në fonde, planifikim projektor dhe aftësi komunikimi	X	X					NJVL	12.000 €
3	Përgatitje të një udhëzuesi për investues		X	X				Zyrë e ZHLE	14.000 €
4	Shqyrtimi për nevojë nga kuador			X	X			NJVL dhe zyra e ZHLE	12.000 €
5	Krijimi dhe azhurimi të WEB faqes me projekte aktuale dhe të ardhshme		X	X	X	X	X	NJVL dhe zyra e ZHLE	7.000 €
6	Themelimi i kontakteve me investues lokal dhe të huaj			X				NJVL dhe zyra e ZHLE	8.000 €
7	Bashkëpunimi i rregullt me të gjitha institucionet shtetërore	X	X	X	X	X	X	NJVL	6.000 €

Promovimi i tërheqjes së fondeve të ndryshme burime

	AKTIVITETE	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Promovimi i partneritetit	X						Prefekt dhe NJVL	4.000 €
2	Lobim rrjedhor deri te të gjithë aktorët relevant (donatorë ndërkombëtarë dhe të vendit, institucione shtetërore)	X	X	X	X	X	X	NJVL	12.000 €
3	Takime të hapura tremujore me sektorin privat		X	X	X	X	X	NJVL	5.000 €
4	Prezantim në mediat		X		X			NJVL i Ndërmarrja publike komunale (NPK)	16.000 €
5	Mundësim i kushteve lehtësuese për investuesit e ardhshëm (taksa komunale dhe administrative)	X	X					NJVL	5.000 €
6	Botimi i broshurave për biznese aktive dhe të mundshme në Gostivar		X		X			Qendër informative dhe NJVL	8.000 €
7	Praktikimi i sistemit një sportel	X	X	X	X	X	X	NJVL	12.000 €

4.3.1. QËLLIM 2

PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SË PËRGJITHSHME NË FUNKSION TË CILËSISË SË JETËS DHE ZHVILLIMIT LOKAL TË KOMUNËS

Sipas pozitës gjeografike, Gostivari gjendet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë, në pjesën e lartë të luginës së Pollogut, në pjesën jugore të fushës së Gostivarit. Nëpër territorin e komunës kalon koridori strategjik E-8, i cili paraqet lidhje e rëndësishme për zhvillimin ekonomik në rajon.

Autostrada moderne, hekurudha ekzistuese, rruge dhe gjitha infarastruktura ekzistuese paraqesin faktor të rëndësishëm për zhvillim të shpejtë ekonomik.

Për zhvillimin ekonomik gjithashtu është e rëndësishme lidhshmëria rajonale e cila është realizuar me modernizimin e rrjetit rrugor lokal dhe rajonal. Në funksion të zhvillimit lokal, perspektiv paraget bashkëpunimi ndërkufitar me Kosovën dhe Shqipërinë. Vendpозita



e komunës së Gostivarit jep mundësi të mira për bashkëpunim ekonomik, arsimor, kulturor etj.

Ndërtimi i rrjetit rrugor lokal tërësisht nuk i plotëson nevojat dhe paraqet pengesë për zhvillimin më të shpejtë ekonomik dhe për shfrytëzimin më të mirë të resurseve natyrore.

Në qytet dhe në vendet tjera, ndërtimi i infrastrukturës komunale nuk është në nivel të duhur. Akoma është aktual problemi i pastrimit të ujrave të zeza, kanalizimeve fekale nëpër fshatra, furnizimi me ujë në qytet dhe posaçërisht në mjediset rural, deponimi i plehrave të forta dhe mbeturinave teknologjike etj. Faktori që kufizon tejkalimin e problemeve të tilla është mungesa e mjeteve financiare për shkak të fuqisë së dobët financiare të komunis, mirëpo edhe për arsye të standardit të ulët të popullatës.

4.3.2. ANALIZA SWOT

Qëllim	Përmirësimi i infrastrukturës së përgjithshme në funksion të cilësisë së jetës dhe zhvillimit lokal të komunës
Përparësi	<ol style="list-style-type: none">1. Resurse njerëzore për përgatitje të projekteve2. Vendpozita e mirë gjeografike e komunës (koridori E-8, afërsia e aeroporteve në Shkup dhe Ohër)3. Proejkte në fazë realizimi4. Dokumentacioni i përgatitur teknik për objekte infrastrukture të reja5. Infrastruktura ekzistuese (shëndetësore, arsimore, telekomunikimi)
Dobësi	<ol style="list-style-type: none">1. Moskryerje e ndërtimit të objekteve infastrukturore2. Vjetrimi i rrjetit ekzistues ujësjellës në Gostivar3. Moskujdesi i infrastrukturës rurale4. Mospagimi i taksave komunale dhe pagimet për shërbime nga ana e qytetarëve
Kërcënime	<ol style="list-style-type: none">1. Korrupsioni2. Hyrja në fondet shtetërorë është e varur nga përkatësia politike3. Standardi i ulët i popullatës4. Borxhe të trashëguara nga NJVL5. Pagimi i parregullt i TVSHsë
Mundësi	<ol style="list-style-type: none">1. Decentralizimi dhe ingjerenat e reja të komunës2. Fonde të disponueshme shtetërorë dhe ndërkombëtare3. Gatishmëria e banorëve për vetëkontribut4. Fonde investuese

4.3.3. LOGJIKA E INTERVENIMIT

PROBLEM	MASA	AKTIVITETE
Infrastruktura e pamjaftueshme dhe jociësore lokale	1. Zgjedhja e problemit të ujit të pastër dhe të shëndetshëm për të pirë	1.1 Ndërtimi i stacionit pastrues në qytetin e Gostivarit 1.2 Sanimi i sistemit të ujësjellësit në f. Debreshtë 1.3 Ndërtimi i rrjetit të ujësjellës në f. Çegran 1.4 Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Srbinovë 1.5 Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit të vjetër me të ri në Gostivar
	2. Zgjedhje e problemit me kanalizimin të përshtatshëm të ujrave të zeza	2.1 Ndërtimi i stacionit pastrues për ujra të zeza në Gostivar 2.2 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Fazanerija 2.3 Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Çegrane 2.4 Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Forino 2.5 Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Debreshtë 2.6 Ndërtim i kanalizimit fekal në f.Balindol 2.7 Përgatitje e planit (projekt) të përgjithshëm për grumbullimin e ujrave të zeza dhe atmosferike
	3. Zgjedhje e problemit me rruget lokale, trotuarët, parqet dhe gjelbërimi	3.1 Hapja dhe ndërtimi i një pjese të bulevardit Braka Ginoski, rruga garkore 101, rruga garkore e re në jug të qytetit 3.2 Zgjërimi i rrugës Gostivar – Çegran 3.3 Ndërtim i rrugës lokale Debreshte – Gostivar 3.4 Zona e gjashtë – ndërtim të rrugës dhe trotuarëve 3.5 Rikonstruimi i asfaltit në Rr. Beliçica 3.6 Ndërtim të trotuarëve në f. Debreshte 3.7 Regullimi i shtratit të lumit Vardar



4.3.4. PLANI AKSIONAR

Zgjedhja e problemit të ujit të pastër dhe të shëndetshëm për të pirë

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Ndërtimi i stacionit pastrues në qytetin e Gostivarit	X	X					NJVL dhe NKP	45.000 €
2	Sanimi i sistemit të ujësjellësit në f. Debreshtë	X	X					Bashkësia lokale (BL), NJVL dhe NKP	50.000 €
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në f. Çegran		X	X				BL, NJVL dhe NKP	150.000 €
4	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellës në f. Srbinovë			X				BL, NJVL dhe NKP	35.000 €
5	Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellës të vjetër me të ri në Gostivar		X	X	X	X	X	NJVL dhe NKP	2.500.000 €

Zgjedhja e problemit me kanalizimin të përshtatshëm të ujrave të zeza

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Ndërtimi i stacionit pastrues për ujra të zeza në Gostivar				X	X	X	NJVL dhe NKP	3.500.000 €
2	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjen Fazanerija		X					NJVL, NKP dhe BL	250.000 €
3	Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Çegrane			X	X	X	X	NJVL, BL dhe NKP	1.600.000 €
4	Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Debreshtë				X	X	X	NJVL, BL dhe NKP	2.200.000 €
5	Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Forino			X	X	X	X	NJVL, BL dhe NKP	2.000.000 €
6	Ndërtimi i kanalizimit fekal në f.Balindol			X	X	X	X	NJVL, BL dhe i NKP	1.100.000 €
7	Përgatitje e planit (projekt) të përgjithshëm për grumbullimin e ujrave të zeza dhe atmosferike		X	X				NJVL, reparti për urbanizëm dhe NKP	35.000 €





Zgjedhja e problemit me rrugës lokale, trotuarët, parqet dhe gjelbrimi

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Hapja dhe ndërtimi i një pjese të bulevardit Braza Ginoski, rruga garkore 101, rruga garkore e re në jug të qytetit	X	X					NJVL dhe Fondi për udha	360.000 €
2	Zgjerimi i udhës Gostivar – Çegran		X	X				NJVL dhe Fondi për udha	200.000 €
3	Ndërtim i rrugës lokale Debreshte – Gostivar		X					NJVL dhe Fondi për udha	150.000 €
4	Zona e gjashtë – ndërtimi të rrugës dhe trotuarëve				X	X		NJVL dhe Fondi për udha	300.000 €
5	Rikonstruimi i asfaltit në Rr. Beliçica		X					NJVL	30.000 €
6	Ndërtimi i trotuarëve në f. Debreshte			X				BL dhe i NJVL	20.000 €
7	Regullimi i shtratit të lumit Vardar		X	X				NJVL dhe NKP	80.000 €

4.4.1. QËLLIMI 3:

PËRKRAHJA E KAPACITETEVE EKZISTUESE INDUSTRIALE, BIZNESET EKZISTUES PRIVATE NËPËRMJET ADAPTIMIT, THEMELIMIT, RRIJES DHE ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Në moment në komunë në mënyrë aktive punojnë 2,577 subjekte afariste. Një pjesë janë ndërmarrje të cilat janë të privatizuara apo gjenden në fazë të transformimit pronësor. Pjesa më e madhe kanë lëshuar nga puna një pjesë të punsuarve si tepricë teknolojike dhe ballafaqohen me probleme serioze financiare. Kjo gjendje është pasojë e prodhimit të ulësuar, treqjet e hupura tradicionale, si edhe kapacitetet e veta të pamjaftueshme organizative dhe menaxhuese. I nevojshëm është konsolidimi i tyre, në pjesën e strukturimit të sërishëm të kuadrit dhe organizimit, si edhe renovimi i paisjeve që janë të amortizuara dhe të harxhuara, dhe gjetja e partnereve strategjik. Me kryerjen e këtyre aktiviteteve ndërmarrjet do të aftësohen në pranimin dhe realizimin e investimeve.

Sa i përket punësisë dhe papunësisë në komunë, shkalla e papunësisë është gati 60% të popullatës së aftë për punë.

Dalja e mundshme nga kjo situatë është themelimi, rritja dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Potenciali i komunës së Gostivarit është i volitshëm sa i përket mundësive për zhvillim të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Rajoni ka në disponim resurse të mira natyrore dhe vendpozitë të shkëlqyer (koridori E - 8, afërsia e kufirit me Kosovën; biznes sektor i lëvizur etj. E gjithë kjo krijon parakushte të mira për themelim dhe adaptim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, posaçërisht në domenin e shërbimeve, mjeshtërisë, industrisë me dru, bujqësisë, industrisë tekstile, ndërtimtarisë, xehësisë etj. Zhvillimin i ekonomisë lokale në komunë e themelojmë mbi zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për arsye se bizneset e vegjël mundësojnë ndërlllojshmëri dhe dezirifikim të aktiviteteve afariste. Ata janë edhe element për zhvillim të ndërmarrjeve të mëdha dhe të mesme. Biznesët e vegjël mundësojnë aktivitete të larta produktive ekonomike për arsye të përshtatshmërisë dhe mundësisë shpejtë të reagojnë në treg.

Duke e patur parasysh gjendjen momentale, evidente është nevoja për rol proaktiv të vetëqeverisë lokale që t'a animoj dhe nxis zhvillimin lokal ekonomik. E njëjta mund të bëhet nëpërmjet qasjes strategjike të menduar mirë.



4.4.2. ANALIZA SWOT

Qëllim	Përkrahje e kapaciteteve ekzistuese industriale, bizneset ekzistues privat nëpërmjet adaptimit, themelimit, rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
Përparësi	<ol style="list-style-type: none">1. Resurse ekzistuese njerëzore2. Kapacitete aktive tregtare dhe shërbyese3. Vendpozita e volitshme gjeografike e komunës (korridori E-8, afërsia e aeroporteve në Shkup dhe Ohër)4. Themelimi i sistemit një-sportel5. Punë relativisht të zhvilluara tregtare dhe shërbyese
Dobësi	<ol style="list-style-type: none">1. Partneriteti i pandërtuar publik-privat2. Mungesa e biznes-asociacioneve3. Struktura e pavolitshme e industrisë4. Teknologjia e vjetruar5. Infrastruktura ekzistuese lokale
Kërcënime	<ol style="list-style-type: none">1. Konkurrencë jolojale në tregti (ekonomi e zezë)2. Hyrje e vështirë në kapital (shkallë të larta të kamatave)3. Standardi i ulët i popullatës
Mundësi	<ol style="list-style-type: none">1. Zhvillimi zejeve tradicionale2. Zhvillimi i llojeve alternative të turizmit (gjueti, peshkim, alpinizëm etj.)3. Rrjet i madh i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme4. Interesi i diasporës për financim në komunë

4.4.3. LOGJIKA E INTERVENIMIT

PROBLEM	MASA	AKTIVITETE
Numër i madhi të papunësuarve	1. Krijimi i kushteve për përmirësim të punësimit përmes rolit proaktiv të NJVL Gostivar	1.1 Përgatitje të strategjisë për zhvillim lokal ekonomik 1.2 Formimi i zyrës- agjencion për L.E.R 1.3 Përgatitje e udhëzues për investuesit 1.4 Vizitë shembujve pozitiv ekonomik dhe ndërrimi i përvojave 1.5 Kompletimi i Planit detajor urbanistik (PDU) 1.6 Nxitja dhe themelimi i inkubatorit
	2. Krijim të kushteve për ristrukturim të kapacitetve egzistuese industriale	2.1 Nxitja e privatizimit 2.2 Lobim deri te Qeveria për privatizimin 2.3 Themelim të kontakteve me investuse lokal dhe të huaj 2.4 Botim i broshurave për kapacitetet industriale në Gostivar 2.5 Organizimi i mbledhjes ndërkombëtare për biznes në komunën e Gostivarit 2.6 Sigurimi i infrastrukturës të disponueshme për kapacitetet



4.4.4. PLANI AKSIONAR

Krijim të kushteve për përmirësim të punësimit përmes rolit proaktiv të NJVL Gostivar

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Përgatitje të strategjisë për zhvillim lokal ekonomik	X	X					NJVL në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat	25.000 €
2	Formimi i zyrës-agjencia për L.E.R		X					NJVL	30.000 €
3	Përgatitje e udhëzues për investuesit		X					Zyra e L.E.R	14.000 €
4	Vizitë shembujve pozitiv ekonomik dhe ndërrimi i përvojave			X				NJVL dhe zyra e L.E.R	4.500 €
5	Kompletimi i Planit detal urbanistik (PDU)		X	X				Këshilli dhe reparti për urbanizëm	25.000 €
6	Nxjtja dhe themelimi i inkubatorit			X				Zyrë për L.E.R	6.000 €

Krijim të kushteve për ristrukturim të kapacitetve egzistuese industriale

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Nxisja e privatizimit	X	X					Prefekt i NJVL	12.000 €
2	Lobim deri te Qeveria për privatizimin	X	X	X				NJVL	7.000 €
3	Themelim të kontakteve me investuae lokal dhe të huaj	X	X	X	X			NJVL dhe zyra e ZHLE	16.000 €
4	Botim i broshurave për kapacitetet industrial në Gostivar		X	X				NJVL dhe Qendra informative	8.000 €
5	Organizimi i mbledhjes ndërkombëtare për biznes në komunën e Gostivarit			X				NJVL	12.000 €
6	Sigurim të infrastrukturës të disponueshme për kapacitetet			X	X	X	X	NJVL dhe NKP	100.000 €

4.5.1. QËLLIM 4

ZHVILLIMI I BUJQËSISË, BLEGTORISË, PYLLTARISË DHE XEHTARISË

Qëllimi strategjik për zhvillim të bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe xehtarisë paraqet prioritet afatgjatë zhvillimor për repartin e agronomisë i cili është dominant në pjesën rurale të Gostivarit.

Struktura e sipërfaqes bujqësore dhe pyllet është kryesisht e varur nga natyra hapsinore, kushteve gjeografike, ndërsa shfrytëzimi i tyre varet nga lokacioni i lagjeve dhe shkalla e popullimit-kushtet shoqëro-ekonomike. Në mjedisin rural dominon reliev i lartë dhe kjo është karakteristikë për luginën e Pollogut.

Përbërja e tokës me klasë me bonitet të lartë është supozim i mjaftueshëm për zhvillimin e bujqësisë në kultura të ndryshme të rëndësishme, duke i patur parasysh karakteristikat kohore dhe resurset e disponueshëm ujor. Për zhvillimin e ardhshëm të



bujqësisë në komunë duhet të ndërrohet struktura e tokës sipas pronësisë, privatizimi i tokës e cila gjendet në pronësi shoqërore paraqitet si nevojë e duhur.

Zhvillimi i bujqësisë dhe zgjerimi i sipërfaqeve të përpunueshme është ngushtë i ndërlidhur me ujësimin. Komuna ka disponim potencial të madh ujqor, mirëpo për të shfrytëzuar këtë duhet të mbarohet ndërtimi i infrastrukturës së parshtatshme. Potenciali më i rëndësishëm hidrografik në komunë të Gostivarit është lumi Vardar, e cila ka burimin 5km lnë perëndim nga Gostivari. Investimi në zgjerim të hidro sistemeve do të kontribuoj për zmadhim të fitimeve dhe të sipërfaqeve të përpunueshme, si edhe mundësi për kultura të reja bujqësore.

Hapësirë të dukshme përfshijnë kullosat të cilat janë mes më cilësorëve në Maqedoni për zhvillimin e blegtorisë, pasi që gjenden në vende të larta malore. Ato janë shumë cilësore dhe mundësojnë rritjen e veprimtarisë së blegtorisë, që paraqet bazë për zgjerimin e veprimtarisë në fushën e prodhimitarisë së qumështit, prodhimeve qumështore dhe mishit. Veprimtaria e blegtorisë mund të zhvillohet edhe me themelimin e mini fermave. Për zhvillimin e blegtorisë rëndësi të madhe ka edhe ekzistimi i thertoresh bashkëkohore industriale me frigorifer "Pollogu i Epërm" (i cili u privatizua), i vendosur në qytetin e Gostivarit.

Sipërfaqen më të madhe e mbulojnë pyliet të cilat dallohen sipas cilësisë së tyre varësisht ku janë të pozicionuara –në Sharr, Vraci apo Korab, ose në shkëmbet e malit Suva Gora. Madhësia dhe struktura e pyljeve paraqet një nga potencialet më të rëndësishëm të komunës. Fondi pyllor i disponueshëm është supozimi i parë për zhvillim të industrisë për përpunim të drurit.

Në komunën e Gostivarit ekzistojnë pasuri xehërore të rëndësishme të cilat mund të kenë rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Komunës. Një pjesë ende eksploatohet (f.Srbino), mirëpo akoma ekziston potenciali që nëse shfrytëzohet në mënyrë të organizuar, edhe më shumë mund të arrihet për komunën e Gostivarit.

4.5.2. ANALIZA SWOT

Qëllim	Zhvillim i bujqësisë, së blegtorisë, së pylltarisë dhe na xehtarisë
Përparësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ekzistimi i klasave të tokës me bonitet të lartë 2. Potencial i begatshëm ujqor (ekzistimi i potencialeve të rëndësishëm ujqor-lumi Vardar) 3. Kullota të mëdha dhe kualitative 4. Rajon i pastër ekologjik 5. Thertore ekzistuese industriale me frigorifer 6. Fond i pasur dhe fruta pylllore 7. Fuqi puntore aktive
Dobësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tokë bujqësore e paprivatizuar 2. Infrastrukturë e pandërtuat për ujqitje 3. Mosekzistimi i kapaciteteve përpunuese për pjesë të madhe të prodhimeve bujqësore 4. Shfrytëzimi i papërshtatshëm i pyllieve 5. Politika bujqësore jostimulative 6. Shërbime të pazhvilluara të marketingut 7. Njohuri e pamjaftueshme e bujqëve
Kërcënime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbipopullim i tepërt agrar 2. Plasmani i prodhimeve të pasiguruara 3. Mungesa e mjeteve personale për investim 4. Politika bujqësore jostimulative 5. Qasja e rëndë në kapital 6. Ndryshimet mikro-klimatike
Mundësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjerim të sipërfaqeve të përpunueshme 2. Resurse ekzistuese 3. Hapje e kapaciteteve përpunuese 4. Formimi i shoqatave bujqësore për veprim të organizuar 5. Zhvillimi i marrëdhënieve kooperative



4.5.3. LOGJIKA E INTERVENIMIT

PROBLEM	MASA	AKTIVITETE
Shfrytëzimi i pamjaftueshëm dhe i papërshtahsëm i resurseve ekzistuese në bujqësi, blegtori, pylltari dhe xehtari	1. Promovimi i iniciativave për zmadhimin e prodhimtarisë bujqësore dhe blegtoze	<ul style="list-style-type: none">1.1 Përpunimi të studimit për shfrytëzim më të mirë të potencialeve ujorë në komunën e Gostivarit1.2 Përpunim i projekteve për ndërtim të sistemeve për ujitje1.3 Organizim të trajnimeve për prodhuesit individual bujqësor apo blegtorë me qëllim të zmadhohen kuantiteti dhe cilësia e i prodhimtarisë1.4 Promovimi i prodhimit të ushqimit të shëndetshëm cilësor nga rajoni i Gostivatrit1.5 Nxisja e iniciativave për hapje të stacioneve veterinarë në mjediset rural për përmirësim të mbrojtjes shëndetsore të shtazëve1.6 Infomata për qasje në mikro dhe kredite të vegjël për bujqit dhe blegtorët individual
	2. Afirmimi i kapaciteteve për përpunim të drurit	<ul style="list-style-type: none">2.1 Iniciativa për formim të asociacionit të përpunuesve të drurit2.2 Përpunim i broshurës me informata për potencialet pylltarë në Gostivar2.3 Krijim të kushteve për formim apo riaktivimi i kapaciteteve për përpunim të drurit2.4 Trajnim përmes ndihmë dhe rikualifikime të kuadrit
	3. Krijim të kushteve për shfrytëzim efikas të pasurisë xehërore	<ul style="list-style-type: none">3.1 Formim i ekipit të përzier për realizim të programit3.2 Formim të partneritetit publik-privat me minieret aktive3.3 Përgatitja e studi/plan për shfrytëzim efikas të rezervave xehërore dhe minerale3.4 Përpunim dhe promovim të vendeve xehësore me mundësi për eksploatimin e tyre3.5 Sigurimi i qasjes së lehtësuar për furnizim të mekanizmit dhe maqinave të nevojshme3.6 Rikualifikimi i kuadrit

4.5.4. PLAN VEPRIMOR

Promovimi i iniciativave për zmadhimin e prodhimitarisë bujqësore dhe blegtores

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRÇJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Përpunim të studisë për shfrytëzim më të mirë të potencialeve ujqorë në komunën e Gostivarit	X	X					NJVL, Reparti për urbanizëm, Vodostopanstvo	23.000 €
2	Përpunim i projekteve për ndërtim të sistemeve për ujtitje	X	X	X				NJVL, Reparti për urbanizëm, Vodostopanstvo	29.000 €
3	Organizim të trajnimeve për prodhuesit individual bujqësor apo blegtorë me qëllim të zmadhohen kuantiteti dhe kualiteti i prodhimitarisë		X	X	X			NJVL, zyra e ZHLE i Asociacioni i bujqve	24.000 €
4	Promovimi i prodhimit të ushqimit të shëndetshëm kualitativ nga rajoni i Gostivartit			X	X	X		NJVL, zyra e HLE i Agjensioni për zhvillim	18.000 €
5	Nxjsja e iniciativave për hapje të stacioneve veterinarë në mjediset rural për përmirësim të mbrojtjes shëndetsore të shtazëve			X	X			NJVL i Ministria për bujqësi	20.000 €
6	Infomata për qasje në mikro dhe kredite të vegjële për bujqit dhe blegtorët individual			X	X	X	X	NJVL, zyra e ZHLE dhe banka	16.000 €



Afirmimi i kapaciteteve për përpunim të drurit

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Iniciativa për formim të asociacionit të përpunuesve të drurit	X						NJVL i agjensioni për zhvillim	5.000 €
2	Përpunim i broshurës me informata për potencialet pylltarë në Gostivar		X					NJVL dhe zyra e ZHLE	8.000 €
3	Krijimin e kushteve për formim ose riaktivizimin e kapaciteteve për përpunimin e drurit.		X	X				NJVL, agjensioni për zhvillim, Ministria për ekonomi	20.000 €
4	Trajnim përmes ndihmë dhe rikualifikime të kuadrit				X	X	X	NJVL, zyra e ZHLE i Asociacioni i përpunuesve të drurit	35.000 €

Krijim të kushteve për shfrytëzim efikas të pasurisë xehësore

	AKTIVITET	2006		2007		2008		PËRGJEGJËSI	SHPENZIME
		1-6	7-12	1-6	7-12	1-6	7-12		
1	Formim të skuadrit të përzier për realizim të programit	X						NJVL dhe Bordet e minierëve	4.000 €
2	Formim të partneritetit publik-privat me minieret aktive		X	X				NJVL dhe Bordet e minierëve	7.000 €
3	Pregatitja e studi/plan për shfrytëzim efikas të rezervave xehësore dhe minerale		X	X				NJVL dhe skuadër inzhinierësh nga minierëve	35.000 €
4	Përpunim dhe promovim të vendeve xehësore me mundësi për eksplotimin e tyre		X	X				NJVL dhe zyra e ZHLE	18.000 €
5	Sigurimi i qasjes së lehtësuar për furnizim të mekanizmit dhe maqinave të nevojshme			X	X			NJVL dhe skuadri i përzier	9.000 €
6	Rikualifikimi i kuadrit			X	X	X		NJVL dhe zyra e ZHLE	30.000 €





Adresa: Rr.Braça Ginoski nr.61
Gostivar, Republika e Maqedonisë

tel/faks: (042) 213-511

tel/faks: (042) 214-406

internet faqja: www.gostivari.gov.mk



Library: **International Programmes Regional Cross-Border Program**
Publisher: **Macedonian Center for International Cooperation (MCIC)**
Executive Director: **Saso Klekovski**
Executive Editor: **Gonce Jakovleska**
Copyedit: **Tanja Hafner Ademi**
Text preparation: **Dimce Mitreski**
Translation: **Nita Cavolli**
Proofreading: **Daniel Medarowski, Gramoz Shabani**
Design and layout: **Koma lab. – Skopje**
Printing: Borografika – **Shkupi**
Circulation: **300**

Publisher's address:

Macedonian Center for International Cooperation (MCIC)
Nikola Parapunov nn, P.O. Box 55
1060-Skopje, Macedonia
E-mail: mcms@mcms.org.mk
Website: <http://www.mcms.org.mk>

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced in any form without the permission from the Macedonia Center for International Cooperation.



LOCAL DEVELOPMENT
STRATEGIC PLAN OF THE
MUNICIPALITY OF

GOSTIVAR

March, 2006





CONTENTS

1. INTRODUCTION	89
2. PROFILE OF THE MUNICIPALITY OF GOSTIVAR	91
3. THE APPROACH AND PROCESSES OF PREPARING THE PLAN	95
4. THE VISION AND GOALS FOR FUTURE LOCAL DEVELOPMENT OF THE MUNICIPALITY OF GOSTIVAR	98
4.1 THE VISION	99
4.2 MAIN GOALS	99
4.2.1 GOAL 1	100
4.2.2 SWOT ANALYSIS	101
4.2.3 THE LOGIC OF INTERVENTION	102
4.2.4 ACTION PLAN	103
4.3.1 GOAL 2	105
4.3.2 SWOT ANALYSIS	106
4.3.3 THE LOGIC OF INTERVENTION	107
4.3.4 ACTION PLAN	108
4.4.1 GOAL 3	111
4.4.2 SWOT ANALYSIS	112
